

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR IDENTIFIKIMIN ELEKTRONIK, SHËRBIMET E BESUARA DHE PORTOFOLIN E IDENTITETIT DIGJITAL”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Qëllimi i projektligjit “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital” është vendosja e një kuadri ligjor të qartë dhe të unifikuar për identifikimin elektronik të sigurt, ofrimin e shërbimeve të besuara si dhe ndërtimin dhe funksionimin e portofolit të identitetit digjital, duke garantuar siguri, integritet, ndërveprueshmëri si dhe besueshmëri në transaksionet elektronike si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat.

Projektligji vendos përcaktime të qarta lidhur me nënshkrimin elektronik, vulat elektronike, vulat kohore elektronike, shërbimin elektronik të regjistruar të transmetimit, autentifikimin e faqeve të internetit, arkivimin elektronik dhe vërtetimin elektronik të atributëve, menaxhimin e pajisjeve të krijimit të nënshkrimit elektronik, menaxhimin e pajisjeve të krijimit të vulës elektronike dhe regjistrat elektronike në Republikën Shqipërisë si dhe vendos një bazë solide për ndërtimin dhe funksionimin e identitetit digjital në përputhje me standardet evropiane.

Projektligji synon përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të besuara duke bërë të mundur një qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në shërbimet e ofruara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar, me qëllim garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë në përdorimin e shërbimeve të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara nga qytetarët, bizneset dhe administrata publike, për të hyrë në shërbimet online ose për të menaxhuar transaksionet elektronike në vend.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- krijimi një kuadri ligjor të plotë dhe të unifikuar për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, njohjen reciproke dhe ndërveprueshmërinë e tyre;
- rritja e sigurisë për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, duke siguruar një bazë të përbashkët për bashkëveprim të sigurt elektronik midis qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve publike, duke rritur efektivitetin, integritetin, sigurinë dhe besueshmërinë në ofrimin e shërbimeve të besuara në Republikën e Shqipërisë;
- ndërtimi dhe funksionimi i Portofolit të Identitetit Digjital si mjet i qëndrueshëm dhe i besueshëm për menaxhimin e identitetit digjital;
- përafrimi i kuadrit ligjor për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara me acquis e BE , rregulloren eIDAS1 dhe eIDAS2, duke përmbushur një nga kushtet thelbësore për

përafrimin e Shqipërisë me *acquis communautaire* në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara si pjesë e procesit të integritetit evropian.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Projektligji i propozuar për miratim është hartuar në bazë të neneve 78, 81, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Projektligji është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, për vitin 2025, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 818, datë 26.12.2024 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025.”

Ky akt është hartuar gjithashtu në kuadër të përmbushjes të detyrimeve të marra përsipër nga Vendimi nr. 621, datë 10.10.2024 “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor”

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Zhvillimet teknologjike dhe transformimi digjital i shërbimeve kërkojnë mekanizma të standardizuar dhe të sigurt për të identifikuar përdoruesit dhe për të ruajtur vlefshmërinë ligjore të transaksioneve elektronike.

Aktualisht, mungesa e një ligji të konsoliduar që të përcaktojë rregulla të qarta për njohjen reciproke të skemave të identifikimit elektronik, funksionimin e portofolit të identitetit digjital, rregullimin e shërbimeve të reja të besuara në përputhje me përcaktimet e BE në këtë fushë, detyrimet dhe standardet për ofruesit e kualifikuar dhe jo të kualifikuar të këtyre shërbimeve, si dhe njohjen ndërkufitare të skemave dhe shërbimeve të besuara, nxjerr në pah nevojën për miratimin e një kuadri ligjor të unifikuar dhe të harmonizuar, që siguron identitet të besueshëm digjital për qytetarët, si dhe ndërveprueshmëri të plotë me sistemet dhe standardet evropiane.

Aktualisht kuadri ligjor në fuqi, përkatësisht ligji nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, dhe ligji nr.9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik”, pësuan ndryshime në vitin 2016. Këto dy ligje si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre kanë transpozuar pjesërisht Rregulloren Evropiane nr. 910/2014 “Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm” (eIDAS).

Duke qenë se kuadri ligjor ekzistues që rregullon fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara në Republikën e Shqipërisë është vetëm pjesërisht i përafruar me rregulloren e BE-së,

eIDAS 910/2014, si dhe duke qenë se rregullorja eIDAS1 dhe eIDAS2 kanë zgjeruar dhe përmirësuar ndjeshëm kuadrin rregullator në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara shihet e arsyeshme hartimi i një ligji të ri, duke përfshirë të gjithë elementët që aktualisht mungojnë në legjislacionin ekzistues, me qëllim garantimin e bazës së duhur ligjore në ofrimin e shërbimeve të besuara, si dhe vendosjen e rregullave të qarta për të gjithë palët e përfshira.

Përparësitë e projektligjit

Projektligji përcakton metoda të reja për identifikimin e aplikuesit për pajisjen me mjete të identifikimit elektronik (identifikimi në distancë) duke reduktuar në këtë mënyrë proceset administrative që kërkojnë kohë.

Në krahasim me kuadrin aktual ligjor ky projektligj rrit kërkesat e sigurisë dhe besueshmërinë në veprimtarinë e ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara ku ofruesit e këtyre shërbimeve duhet të aplikojnë standardet më të përparuara të sigurisë, të përshtatshme për rreziqet që lidhen me aktivitetet e tyre në mënyrë që të nxitin besimin e përdoruesve. Të gjithë ofruesit e shërbimeve të besuara janë objekt i kërkesave të këtij ligji, në veçanti kërkesave për sigurinë dhe përgjegjësinë për të siguruar kujdesin e duhur, transparencën mbi shërbimet dhe veprimtarinë e tyre. Duke përcaktuar standarde të qarta për ofruesit e shërbimeve të besuara dhe për përdorimin e identifikimit elektronik, projektligji kontribuon në rritjen e sigurisë juridike dhe teknike për të gjitha palët e përfshira. Jo vetëm kaq por projektligji zgjeron fushën e zbatimit të tij duke bërë gjithashtu edhe rregullime për sa i përket ofruesve jo të kualifikuar të shërbimeve të besuara.

Ky projektligj përcakton rregullime lidhur me ndërtimin e portofolit të identitetit digjital, një mekanizëm i cili do t'i japë çdo qytetari një mjet të sigurt, të kontrolluar dhe të centralizuar për përdorimin e identitetit të tij digjital në mënyrë të besueshme duke ruajtur privatësinë si dhe duke thjeshtuar ndjeshëm aksesin në shërbime publike e private.

Gjithashtu ky projektligji do të prezantojë listën e besuar të ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara dhe listën e pajisjeve të certifikuara të krijimit të nënshkrimeve elektronike dhe vulave elektronike të kualifikuara, do të rregullojë ruajtjen afatgjatë të informacionit dhe vlefshmërinë ligjore të nënshkrimeve dhe vulave elektronike si dhe do të parashikojë vlerësimin e tyre pavarësisht nga ndryshimet e ardhshme teknologjike.

Nëpërmjet këtij ligji zgjerohen shërbimet e besuara të cilat do të mund të ofrohen në RSH si shërbimi i kualifikuar i ruajtjes së nënshkrimeve/vulave elektronike të kualifikuara si dhe shërbimi i kualifikuar i vërtetimit të vlefshmërisë së nënshkrimeve/vulave elektronike, arkivimi elektronik dhe vërtetimi elektronik i attributeve, menaxhimi i pajisjeve të krijimit të nënshkrimit elektronik/vulës elektronike dhe regjistrat elektronikë.

Projektligji përfaqëson një hap të rëndësishëm në përfrimin e kuadrit ligjor shqiptar me rregulloren eIDAS1 dhe Eidas2, duke mundësuar një qasje të sigurt dhe të ndërveprueshme ndaj shërbimeve elektronike në nivel ndërkombëtar.

Problematikat

Zbatimi i këtij projektligji shoqërohet gjithashtu edhe me disa sfida të rëndësishme të tilla si psh. zhvillimi dhe certifikimi i portofolit të identitetit digjital kërkon kapacitete të konsiderueshme teknike dhe burime financiare adekuate. Ky proces përfshin ngritjen e sistemeve të sigurt, të besueshme dhe të përputhshme me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu zbatimi i dispozitave të këtij ligji do të kërkojnë investime të mëdha në infrastrukturën teknologjike dhe trajnimin e aktorëve të përfshirë (psh Ofruesit e Shërbimeve të Besuara), investime këto të domosdoshmë për të siguruar përmbushjen e standardeve ligjore dhe teknike që do të përcaktohen.

Efektet e pritshme

Projektligji vendos një kuadër të qartë dhe të standardizuar për përdorimin e mjeteve të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara, duke garantuar integritetin, autenticitetin dhe vlefshmërinë ligjore të transaksioneve elektronike duke kontribuar kështu drejtpërdrejt në rritjen e besimit të qytetarëve dhe bizneseve në përdorimin e shërbimeve digjitale, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Përdorimi i portofolit të identitetit digjital do t'u mundësojë individëve dhe bizneseve akses të sigurt, të unifikuar dhe të ndërveprueshëm ndaj shërbimeve online, jo vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, por edhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar.

Gjithashtu përdorimi i shërbimeve të besuara do të mundësojë përshtetimin e procedurave administrative, reduktimin e ndërveprimeve fizike dhe rritjen e transparencës në ofrimin e shërbimeve publike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në harmoni me legjislacionin vendas në fuqi. Gjithashtu ky projektligj nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj përfron në mënyrë të plotë Rregulloren (BE) nr.910/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 korrik 2014 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, dhe që shfuqizon direktivën

1999/93/KE”, Numri CELEX 32014R0910, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. L257, datë 28.8.2014, faqe 73-114” dhe Rregulloren nr. 2024/1183 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 Prill 2024, që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 910/2014 lidhur me krijimin e Identitetit Digjital Evropian , Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, 2024/1183 datë 30.04.2024, faqe 73-114”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Referuar përmbajtjes së projekt aktit, projektligji ka në përmbajtje 7 (shtatë) krerë (të përbërë nga seksionet përkatëse) si dhe 7(shtatë) anekse, përkatësisht, si më poshtë vijon:

- Në kreun I përcaktohen dispozitat e përgjithshme.

Nenet 1, 2 dhe 3 të projektligjit përcaktojnë qëllimin, objektin dhe fushën e veprimit si dhe përkufizimet në kuptim të këtij projektligji.

Në nenin 4 përcaktohet Autoriteti mbikqyrës ndërsa në nenin 5 përcaktohet parimi i tregut të brendshëm.

Në nenin 6 përcaktohet përdorimi i pseudonimeve në një transaksion elektronik kur nuk përcaktohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.

Nenet 7-12 përmbajnë përcaktime lidhur me portofolin e identitetit digjital, elementët përbërës, kriteret teknike të portofolit, palët e përfshira në të, certifikimi i portofolit të identitetit digjital, publikimi i listës së identitetit digjital, përcaktime lidhur me shkeljet e sigurisë së portofolit si dhe përcaktime lidhur me ndërveprimin e portofolëve.

- Në Kreun II përcaktohen dispozita lidhur me identifikimin elektronik.

Në nenin 13 përcaktohet njohja reciproke e skemave të identifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara, kriteret për njohjen e tyre. Gjithashtu përcaktohet se njohja dhe zbatimi i skemave të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara, do të bëhet në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë me shtetet e huaja, për pranimin e tyre dhe shkëmbimin e të dhënave. Gjithashtu ky nen përcakton edhe njohjen e identifikimit dhe shërbimet e besuara të ofruara nga Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara, të cilët operojnë në vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe që janë të akredituar nga Autoriteti mbikëqyrës përkatës, do të kenë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese, si ato të lëshuara nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, që operon në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14 përcakton njoftimin e skemave të identifikimit elektronik, kërkesat që duhet të plotësojnë ndërsa *neni 15* përcakton nivelet e sigurisë së skemave të identifikimit elektronik.

Në nenin 16 përcaktohet njoftimi i skemave të identifikimit elektronik, përkatësisht publikimi i tyre nga Autoriteti në faqen zyrtare të tij si dhe informacionin që duhet të përmbajë ky publikim.

Neni 17 përmban përcaktime lidhur me shkeljen e sigurisë në skemat e identifikimit elektronik, ndërsa *neni 18* përmban përcaktime lidhur me përgjegjësinë në rastin e shkakimit të dëmit në rastet e shkeljes së përcaktimeve të nenit 14 të këtij projektligji.

Neni 19 përmban përcaktime lidhur me përputhjen e identitetit ndërkufitar ndërsa në *neni 20* përmban përcaktime lidhur me kuadrin e ndërveprimit të skemave kombëtare të identifikimit elektronik.

Neni 21 përcakton certifikimin e skemave të identifikimit elektronik ndërsa në *nenin 22* përcaktohet aksesimi në karakteristikat hardëare dhe softëare të ofruesve të portofolit dhe lëshuesve të mjeteve të identifikimit elektronik.

- Kreu III përmban përcaktime lidhur me shërbimet e besuara dhe përbëhet nga 8 (tetë) seksione.

Seksioni I përmban dispozita të përgjithshme.

Në *nenin 23* përcaktohet përgjegjësia dhe barra e provës të ofruesve të shërbimeve të besuara në rastet e shkakimit të dëmit personit fizik apo juridik.

Në *nenin 24* përcaktohen rregullime lidhur me shërbimet e besuara në aspektin ndërkombëtar, përkatësisht njohja e shërbimeve të besuara të ofruara nga një ofrues i shërbimit të besuar të themeluar në një vend të tretë ose organizatë ndërkombëtare shërbimet e të cilit do të njihen si ligjërisht ekuivalente me shërbimet e besuara të ofruara nga një OKSHB i themeluar në BE mbi bazën e akteve ligjore ose marrëveshje të lidhur midis BE dhe vendit të tretë apo organizatës ndërkombëtare.

Në *nenin 25* përcaktohet aksesimi për personat me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta ku parashikohet se përdorimi i mjeteve të identifikimit elektronik, shërbimeve të besuara dhe produkteve për përdoruesin fundor duhet të jetë i mundur në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta si të moshuarit dhe personat me akses të kufizuar në teknologjitë digjitale.

Seksioni 2 përmban përcaktime lidhur me shërbimet e besuara jo të kualifikuara.

Në *nenin 26* përcaktohen kërkesat që duhet të përmbushen nga ofruesit e shërbimeve të besuara përkatësisht marrja e masave të duhura teknike dhe organizative për menaxhimin e risqeve në shërbimet që ata ofrojnë, njoftimi lidhur me çdo shkelje të sigurisë apo humbje të integritetit.

Neni 27 përmban përcaktime lidhur me kërkesat që duhet të përmbushë një ofrues jo i kualifikuar i shërbimit të besuar që ofron shërbime të besuara jo të kualifikuara.

Seksioni 3 përmban përcaktime lidhur me shërbimet e besuara të kualifikuara.

Në nenin 28 përcaktohet mbikëqyrja e ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar (dorëzimi i raportit të vlerësimit të konformitetit, heqja e statusit “i kualifikuar”), ndërsa *në nenin 29* përcaktohet fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së OKSHB (dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës për marrjen e statusit “i kualifikuar”, procedura për dhënien e statusit).

Në nenin 30 përmban përcaktime lidhur me krijimin, mbajtjen dhe publikimin e listës së besuar nga Autoriteti ndërsa *në nenin 31* përcaktohet marka e besuar e BE për shërbimet e besuara të kualifikuara.

Në nenin 32 përcaktohet kërkesat për ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar në rastin e lëshimit të një certificate të kualifikuar ose një vërtetimi elektronik të kualifikuar të attributeve duke përcaktuar kërkesat që duhet të përmbushen për për verifikimin e identitetit dhe verifikimin e attributeve.

Neni 33 përcakton njohjen e shërbimeve të besuara të kualifikuara në një shtet të BE.

Seksioni 4 përmban përcaktime lidhur me nënshkrimet elektronike.

Në nenin 34 përcaktohen efektet ligjore të nënshkrimit elektronik, ndërsa *në nenin 35* kërkesat që duhet të përmbushë një nënshkrim elektronik i avancuar.

Neni 36 përmban përcaktime lidhur me përdorimin e nënshkrimeve elektronike në shërbimet publike ndërsa *neni 37* përmban përcaktime lidhur me certifikatat për nënshkrim të kualifikuar.

Në nenin 38 përcaktohen kërkesat për pajisjet për krijimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ndërsa *në nenin 39* përcaktohen kërkesat për shërbimin e kualifikuar për menaxhimin e pajisjeve të krijimit të nënshkrimit elektronik të kualifikuar në distancë.

Neni 40 përmban përcaktime lidhur me certifikimin e pajisjeve për krijimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ndërsa *neni 41* përmban publikimin e listës së pajisjeve të certifikuara për krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar.

Neni 42 përmban kërkesat për vërtetimin e vlefshmërisë së nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ndërsa *neni 43* përmban kërkesat për vërtetimin e vlefshmërisë së nënshkrimeve elektronike të avancuara bazuar në certifikata të kualifikuara.

Neni 44 përmban përcaktime lidhur me shërbimin e kualifikuar të vërtetimit të vlefshmërisë së nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ndërsa *neni 45* përmban përcaktime lidhur me shërbimin e kualifikuar të ruajtjes së nënshkrimeve elektronike të kualifikuara.

Seksion 5 përmban dispozita lidhur me vulat elektronike.

Neni 46 përmban përcaktime lidhur me efektet ligjore të vulave elektronike ndërsa *neni 47* përmban kërkesat për vulat elektronike të avancuara.

Neni 48 përmban përcaktime për përdorimin e vulave elektronike në shërbimet publike ndërsa *neni 49* përcaktohen certifikatat e kualifikuara për vualat elektronike.

Neni 50 përmban përcaktime lidhur me pajisjet për krijimin e vulave elektronike të kualifikuara ndërsa *neni 51* përcakton kërkesat për shërbimin e kualifikuar për menaxhimin e pajisjeve të krijimit të vulave elektronike të kualifikuara në distancë.

Neni 52 përcakton shërbimin e vërtetimit të vlefshmërisë dhe ruajtjes së vulave elektronike të kualifikuara ndërsa *neni 53* përmban kërkesat për vërtetimin e vlefshmërisë së vulave elektronike të avancuara bazuar në certifikata të kualifikuara.

Seksioni 6 përmban përcaktime lidhur me vualat kohore elektronike.

Në *nenin 54* përcaktohen efektet ligjore të vulës kohore elektronike ndërsa në *nenin 55* përcaktohen kërkesat për vulën kohore elektronike të kualifikuar.

Seksioni 7 përmban përcaktime lidhur me shërbimet e transmetimit elektronik të kualifikuar.

Neni 56 përcakton efektet ligjore të ofrimit të shërbimeve të transmetimit elektronik të regjistruar ndërsa *neni 57* përcakton kërkesat për ofrimin e shërbimeve të transmetimit elektronik të kualifikuar të regjistruar.

Seksioni 8 përmban përcaktime lidhur me autentifikimin e faqeve në internet.

Neni 58 përcakton kërkesat për certifikata të kualifikuara për autentifikimin e faqeve në internet.

Në *nenin 59* përcaktohen masat parandaluese të sigurisë kibernetike nga ofruesit e shfletuesve të internetit.

- Kreu III përbëhet nga tre seksione, në seksionin 9 ku përcaktohen vërtetimi elektronik i atributëve, *nenet 60-66*, seksioni 10 ku përcaktohen shërbimet e arkivimit elektronik, *nenet 67-68* si dhe seksioni 11, *nenet 69-70*.

Neni 60 përcakton efektet ligjore të vërtetimit elektronik të atributëve, ndërsa *neni 61* përmban përcaktime lidhur me vërtetimin elektronik të atributëve në shërbimet publike.

Neni 62 përcakton kërkesat për vërtetimin elektronik të kualifikuar të atributëve, ndërsa *neni 63* përmban përcaktime lidhur me verifikimin e atributëve kundrejt burimeve autentike.

Neni 64 përcakton kërkesat për vërtetimin elektronik të atributëve të lëshuara nga ose në emër të një organi të sektorit publik përgjegjës për një burim autentik, ndërsa *neni 65* përmban përcaktime lidhur me lëshimin e vërtetimit elektronik të atributëve të Portofolave të Identitetit Digjital nga ofruesit e vërtetimeve elektronike të atributëve/ofruesit e vërtetimeve elektronike të kualifikuara të atributëve.

Neni 66 përcakton rregullat shtesë për ofrimin e shërbimeve të vërtetimit elektronik të atributëve.

Neni 67 përcakton efektin ligjor të shërbimeve të arkivimit elektronik ndërsa *neni 68* përcakton kërkesat për shërbimet e arkivimit elektronik të kualifikuara.

Në nenin 69 përcaktohet efekti ligjor i regjistrimit elektronik ndërsa *në nenin 70* përcaktohen kërkesat për regjistrat elektronik të kualifikuar.

Neni 71 përcakton efektet ligjore të dokumenteve elektronik.

- Kreu V përcakton kuadrin e qeverisjes.

Neni 72 përmban përcaktime lidhur me mbikëqyrjen e kuadrit ligjor të Portofolit të Identitetit Digjital (praninë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe detyrat e tij).

Neni 73 përcakton rregulla mbi mbikëqyrjen e shërbimeve të besuara (autoritetin përgjegjës dhe kompetencat e tij lidhur me shërbimet e besuara) ndërsa *në nenin 74* përcaktohet pika e vetme e kontaktit.

Neni 75 përmban përcaktime lidhur me ndihmën e ndërsjellë ndërsa *neni 76* përmban përcaktime lidhur me Grupin Evropian të Bashkëpunimit të Identitetit Digjital.

- Kreu VI përcakton kundërvajtjet.

Neni 77 përcakton se cilat shkelje do të konsiderohen kundërvajtje administrative në kuptim të këtij projektligji dhe *në neni 78* përcaktohet masa konkrete “gjobë” lidhur me këto shkelje ndërsa *neni 79* procedurën e vendosjes së dënimit administrativ gjobë.

- Kreu VII përcakton dispozitat e fundit.

Në nenin 80 përcaktohen aktet nënligjore që do nxirrn në zbatim të këtij ligji, *nenin 81* shfuqizime, *nenin 82* dispozitat kalimtare dhe *nenin 83* hyrja në fuqi.

- Aneksi I përmban kërkesat për certifikata të kualifikuara për nënshkrime elektronike.
- Aneksi II përmban kërkesat për pajisjet e krijimit të nënshkrimit elektronik të kualifikuar.
- Aneksi III përmban lërkesa për certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike.
- Aneksi III përmban lërkesa për certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike.
- Aneksi IV përmban kërkesat për certifikata të kualifikuara për autentifikimin e faqeve të internetit.
- Aneksi V përmban kërkesat për vërtetim elektronik të kualifikuar të attributeve.
- Aneksi VI përmban listën minimale të attributeve.
- Aneksi VII përmban kërkesat për vërtetimin elektronik të attributeve të lëshuara nga ose në emër të një organi përgjegjës për një burim autentik.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTIT.

Ngarkohen për zbatimin e këtij ligji Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, të gjithë organet publike, Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, Ofruesit jo të kualifikuar të shërbimeve të besuara, Organet e vlerësimit të konformitetit, institucioni përgjegjës për akreditimin në Republikën e Shqipërisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.

Projektligji është hartuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji sjell efekte financiare për Buxhetin e Shtetit.

Efektet financiare negative për Buxhetin e shtetit për ata OKSHB që financohen nga Buxheti i Shtetit, në kuadër të investimeve që do të duhet të bëjnë me qëllim përmbushjen e masave të sigurisë, duke qenë se ligji përcakton rritjen e këtyre masave të cilat kërkojnë investime në teknologji dhe në rritjen e kapaciteteve.

Gjithashtu krijimi dhe funksionimi i Portofolit të Identitetit Digjital (nëse do të bëhet nga një subjekt shtetëror) kërkon investime të konsiderueshme në infrastrukturë, teknologji dhe kapacitete njerëzore, çka përbën një ngarkesë financiare për buxhetin në fazat fillestare të zbatimit të ligjit.

Nga ana tjetër, projektligji parashikon mekanizma që gjenerojnë të ardhura për buxhetin e shtetit, të cilat burojnë nga tarifat për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të besuara dhe organeve të vlerësimit të konformitetit. Këto të ardhura pritet të kompensojnë pjesërisht kostot e zbatimit dhe të krijojnë një ndikim financiar pozitiv në periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Analiza e plotë e ndikimit financiar është përfshirë në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA), i cili shoqëron këtë projektligj.